



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1245 prot.

Pukë, më 19.07.2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 05, datë 19.07.2025

PËR SHPALLJEN E TË SHTUNËS SË DYTË TË GUSHTIT SI EVENTIN LOKAL TË PËRVITSHËM "DITA E BAMIRËSISË"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 25 "*Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese*", si dhe në përputhje me objektivat për promovimin e vlerave qytetare, solidaritetit dhe nxitjes së veprimtarive sociale, artistike dhe kulturore me ndikim në komunitet, Këshilli i Bashkisë Pukë, me propozim të kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Shpalljen e të Shtunës së dytë të Gushtit të çdo viti si "Dita e Bamirësisë", një event lokal që do të organizohet dhe promovohet në territorin e Bashkisë Pukë.
2. Qëllimi i këtij eventi është nxitja e vlerave qytetare, bamirësisë, përfshirjes sociale, manifestimeve artistiko-kulturore, përmes një atmosfere festive, pozitive dhe gjithëpërfshirëse.
3. Ky event, i cili synon promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal, do të konsiderohet si një festë lokale e përvitshme dhe do të përfshijë aktivitete të ndryshme për nxitjen dhe promovimin e vlerave të bamirësisë në komunitet, përmes organizimit të veprimtarive sociale, artistike, kulturore, sportive, çlodhëse e argëtuese.
4. Festimet e "Ditës së Bamirësisë" do të organizohen çdo vit të shtunën e dytë të muajit gusht, për të mundësuar pjesëmarrje sa më të gjerë të qytetarëve, turistëve dhe emigrantëve.
5. Ngarkohen strukturat përkatëse të Bashkisë Pukë për hartimin dhe zbatimin e planit organizativ të festës, në bashkëpunim me institucionet vendore, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë lokalë.
6. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 55, pika 6.

Paraqitën projektin;

Drejtori i Menaxhimit të BNJ.

Sokol Gjoni

Juristi

Aida Sinani

Kryetari

Rrok Dodaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1245 prot.

Pukë, më 15.07. 2025

RELACION

Mbi

PROJEKT VENDIMIN

Nr. 05, datë 15.07. 2025

PËR SHPALLJEN E TË SHTUNËS SË DYTË TË GUSHTIT SI EVENTIN LOKAL TË PËRVITSHËM "DITA E BAMIRËSISË"

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Ky relacion paraqet një përmbledhje të arsytimit për shpalljen e së shtunës së dytë të muajit gusht, çdo vit, si "Dita e Bamirësisë" në territorin e Bashkisë Pukë. Kjo nismë vjen si rezultat i vëzhgimeve institucionale, kërkesave nga komuniteti dhe traditës së konsoliduar të ndihmës dhe solidaritetit në zonën tonë.

Arsyet që mbështesin këtë nismë janë si më poshtë:

1. Promovimi i vlerave humane dhe solidaritetit:

Bamirësia është një ndër shtyllat morale më të forta të komunitetit pukjan. Institucionalizimi i një dite të tillë shërben për të promovuar ndihmën e ndërsjellë dhe nxitjen e vullnetarizmit social.

2. Rikthimi i traditave pozitive vendase:

Puka historikisht ka qenë e njohur për ndihmën që jepte ndaj njëri-tjetrit, në raste vështirësie, sëmundjeje, fatkeqësie apo nevoje ekonomike. "Dita e Bamirësisë" do të jetë një simbol që ruan dhe rindez këto vlera.

3. Nxitja e përfshirjes së të rinjve dhe organizatave lokale:

Kjo ditë mund të shfrytëzohet për të angazhuar të rinjtë, shkollat, OJF-të, grupet e besimit fetar dhe bizneset vendore në aktivitete konkrete bamirësie, sociale dhe kulturore.

4. Zhvillimi i një ngjarjeje festive dhe pozitive në kulmin e sezonit veror:

Zgjedhja e së shtunës së dytë të gushtit lidhet me faktin që kjo periudhë ka prezencë të shtuar të emigrantëve dhe vizitorëve në Pukë, duke e kthyer këtë ditë edhe në një festë komunitare me aktivitete sociale, artistike, kulturore dhe sportive.

5. Modelim pozitiv për brezat e rinj:

Kjo ditë do të shërbejë për edukimin qytetar të brezave të rinj në frymën e ndihmës, përkujdesjes dhe përfshirjes sociale.

Për të gjitha sa më sipër, propozojmë që Këshilli Bashkiak i Pukës të miratojë shpalljen e së shtunës së dytë të muajit gusht si “Dita e Bamirësisë”, e cila do të përfshihet në kalendarin e aktiviteteve të përvitshme të Bashkisë dhe do të organizohet në bashkëpunim me strukturat vendore dhe komunitetin.

Përgatiti relacionin

DREJTORI I DREJTORISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SOKOL GJONI

